

Të huajt në Shqipëri

Viti 2022

Tiranë, më 21 Gusht 2023: Në fund të vitit 2022, numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri rezultoi 18.151 banorë, duke pësuar rritje me 21,6 %, krahasuar me 2021.

Numri i të huajve rezidentë në 2022 dominohet nga meshkujt me 62,5 % kundrejt femrave me 37,5 %.

Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2022 ishte 10.127 aplikime, duke shënuar një rritje me 11,2 % krahasuar me vitin 2021.


Të huajt rezidentë me origjinë nga Italia, Kosova dhe Turqia përbëjnë numrin më madh të të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri në 2022, respektivisht me 2.948, 2.829 dhe 1.629 banorë.

Të huajt me origjinë nga Evropa, në vitin 2022 rezultojnë 13.926 banorë dhe përbëjnë 73,3 % të të huajve gjithsej kundrejt 59,1 % që përbënin në 2021.

Arsyeja për punësim është arsyeja kryesore e lejeve të qëndrimit të të huajve në Shqipëri në 2022, me 43,7 %.

Në vitin 2022 janë evidentuar 8.335 të huajt të parregullt në territorin e vendit ku pjesën më të madhe të tyre prej 52,3 % e zënë të huajt me origjinë nga Siria dhe Afganistani.

Fig. 1 Të huajt me leje qëndrimi sipas gjinisë, 2005-2022



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT


Për publikim 21 Gusht 2023

Vijon

Të huajt në Shqipëri

Gjatë 2022 numri i të huajve rezident përbëhet nga 11.345 meshkuj dhe 6.806 femra. Meshkujt zënë 63,0 % në numrin e të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri.

Fig. 2: Piramida e popullsisë së huaj rezidente në Shqipëri



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT


Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2022 është 10.127 aplikime, duke shënuar një rritje me 11,2 % krahasuar me vitin 2021. Aplikimet sipas vendit të origjinës nga Kosova dhe Italia përbëjnë 40,9 % të aplikimeve gjithsej, në 2022.

Tab. 1 Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës 2020-2021

Vendi i origjinës	2021	2022
Itali	1.393	2.064
Iran	2.454	61
Kosovë	1.087	2.073
Turqi	919	782
SHBA	231	252
Egjipt	220	276
Filipine	166	272
Maqedoni e Veriut	161	171
Bangladesh	154	203
Siri	152	181
Tjetër	2.169	3.792
Gjithsej	9.106	10.127

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit , përpunimi INSTAT

Fig. 3 Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas afatit të qëndrimit, 2022




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit , përpunimi INSTAT

Të huajt në Shqipëri sipas kontinenteve

Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, në 2022 kryesohen nga vendet e Evropës, duke zënë 73,3 % të të huajve rezident gjithsej. Të huajt me origjinë nga Evropa janë 13.296, duke shënuar një rritje me 50,9 %, krahasuar me 2021. Të huajt me origjinë nga Azia janë 2.641, duke shënuar një ulje me 37,4 %, krahasuar me 2021. Të huajt me origjinë nga Amerika, Afrika dhe Oqeania janë 2.214, duke pësuar një rritje me 17,3 %, krahasuar me 2021.

Fig. 4 Të huajt me leje qëndrimi sipas kontinenteve, 2005-2022




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit , përpunimi INSTAT

Të huajt në Shqipëri sipas vendit të origjinës

Në 2022 të huajt rezident në Shqipëri me origjinë nga Italia janë 2.948 banorë, duke shënuar një rritje me 26,9 %, krahasuar me 2021. Të huajt me origjinë nga Kosova janë 2.829 banorë, duke shënuar një rritje me 51,4%, krahasuar me 2021.

Fig. 5 Të huajt në Shqipëri sipas vendit të origjinës, 2022




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT

Të huajt në Shqipëri sipas arsyes

Në vitin 2022 të huajt rezident për arsye punësimi zënë 43,7 % të të huajve gjithsej, ndjekur nga arsyet për bashkim familjar me 23,9 %, arsyet për qëllime humanitare me 17,9 %, arsyet për studime 4,0 % dhe arsyet të tjera me 10,5 %.

Fig. 6 Të huajt me leje qëndrimi sipas arsyes, 2022



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT


Te të huajt rezident në Shqipëri me origjinë nga Italia, përveç arsyes për punësim (47,8 %) vihet re edhe një dominim i arsyes për bashkim familjar (17,2 %).

Të huajt me origjinë nga Kosova, kryesohen nga arsyet për bashkim familjar (44,7 %) dhe arsyet të tjera (29,0 %)

Të huajt me origjinë nga Turqia, kryesohen nga arsyet për punësim (63,7 %) dhe arsyet për bashkim familjar (31,7 %).

Të huajt me origjinë nga SHBA dhe Egjipt dominohen nga arsyet për punësim (respektivisht me 54,2 % dhe 74,2 %).

Fig. 7 Të huajt me leje qëndrimi sipas vendit të origjinës dhe motivit, 2022




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT

Të huajt e parregullt

Të huajt e parregullt të evidentuar në territorin e Shqipërisë ose në kufi, pa dokumentacionin e nevojshëm, rezultojnë 8.335 persona në 2022, kundrejt 10.062 personave në 2021.


Fig. 8 Të huajt e parregullt, 2015-2022



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt e parregullt të kapur për herë të parë sipas vendit të origjinës në 2022, kryesohen nga vende si Siria me 3.030 persona, Afganistani me 1.324 persona, Bangladeshi me 1.055 persona, Pakistani me 855 persona dhe Maroku me 301 persona.

Fig. 9 Të huajt e parregullt sipas vendit të origjinës, 2018 - 2022



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përpunimi INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit vjetor i të huajve në Shqipëri është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grupmohave dhe gjinisë, arsyes së aplikimit, vendeve të origjinës si dhe numrin vjetor të aplikimeve të lejeve të qëndrimit. Publikimi gjithashtu paraqet dhe të huajt e parregullt.

Të dhëna mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt sigurohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Përkufizime

I huaj është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

Leje qëndrimi është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.

Person pa shtetësi është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

Leje pune është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, një të huaji, për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.

Bashkim familjar është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë të anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të një të huaji, ose refugjati, banorë në Republikën e Shqipërisë, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.

Anëtarë të familjes së të huajit, azilkërkuesit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykate apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundin objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.

Shërbimi vullnetar është një program aktiviteteve solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.

Studiues dhe specialistë janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.

Qëndrim i parregullt është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shtet apo vend i origjinës është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.